



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:192678
Datë: 27.03.2024
Numri i dokumentit: 05512740

C.nr.1470/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike të paditësit F L. nga fshati P., Komuna e Gj., të cilin e përfaqëson me autorizim avokati Labinot Buzuku nga Prishtina, kundër të paditurës K. e Gj. me seli në Gj., të cilën e përfaqëson me autorizim Burim Maliqi nga Gjilani, me objekt kontesti anulim i njoftimit dhe Kompensim dëmi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik më datën 23.02.2024 mori, ndërsa më datë 26.03.2024 e përpiloi me shkrimi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit F. L. nga fshati P., Komuna e Gj., kundër të paditurës K. e Gj. me seli në Gj., me të cilën ka kërkuar që të OBLIGOHET e paditura, të anulojë njoftimin e datës 23.06.2023 dhe të konstatohet se paditësi i plotëson të gjitha kriteret për t'u zgjedhur në pozitën e drejtorit në Shkollën e Mesme "M. B." në Gj., si dhe t'i paguhet shuma prej 6,000.00 euro, nga e paditura për konstatim të gabuar dhe ulje të autoritetit në vendin e punës, me kamatë prej 8% në vit duke filluar nga data e ushtrimit të padisë në gjykaët, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi F. L. nga Gj., në këtë gjykatë me datë 08.09.2023 ka paraqitur padi përmes të autorizuarit të tij, ndaj të paditurës K. e G., me objekt kontesti anulimi i njoftimit i datës 23.06.2023.

Pretendimet e palëve ndërgjyqjësë:

Lidhur me këtë çështje kjo gjykatë ka caktuar shqyrtimin gjyqësor ku i autorizuari i paditësit, në padi, në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në spjegimet përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të paditësit, duke theksuar se paditësi ka ushtruar postin e zv.

Drejtorit pranë Shkollës së Mesme Ekonomike “M. B.” në Gj., me mandat të tretë radhazi në këtë post, i zgjedhur përmes konkursit publik, ashtu që, më datë 01.06 2023, e paditura ka shpallur konkurs për drejtor të Shkollës së Mesme “M. B.” në Gj., në të cilin konkurs, paditësi ka konkuruar në pozitën e drejtorit. Tutje, ka shtuar se paditësi i është drejtuar edhe Ministrisë së Arsimit për Opinion Ligjor, se a i plotëson kushtet për të aplikuar si drejtor, e që kërkesa e tij është shqyrtuar dhe është konstatuar se nëse do i drejtohej gjykatës me padi, me gjasë do të anulohet konkursi. Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, ka theksuar se njoftimi i datës 23.06.2023, i është lëshuar vetëm sa për t’u eliminuar, e që, i njëjti paditësit i ka shkaktuar vetëm ankth dhe shqetësim, ashtu që, ka paraqitur edhe kërkesën për dëmshpërblim të dhimbjeve shpirtërore. Gjykatës i ka kërkuar që ta aprovojë në tërësi të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta detyrojë të paditurën që të anulohet si të kundërligjshëm njoftimin e lartëcekur si dhe t’ia paguaj shumën prej 6,000.00 euro në emër të dëmshpërblimit për shqetësimin e shkaktuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, edhe atë 135.00 euro në emër të përfaqësimit në seancën gjyqësore.

Përfaqësuesi i të paditurës si në përgjigjen në padi, shqyrtimet gjyqësore ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi të dorëzuar në këtë gjykatë, duke shtuar se e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se procedurat mbi përzgjedhjen e kandidatëve nr. 05/7297, të datës 18.01.2023 kanë qenë në rregull dhe janë zhvilluar konform rregullave ligjore për konkursin e vendeve të punës për drejtor dhe zv. drejtor në arsim në Gjilan, me çka kandidati Fadil Latifi, (këtu paditësi) nuk është përfshirë në listën e ngushtë nga komisioni rekrutues. Ka deklaruar se znj. M.Xh.. ka përfillur të gjitha procedurat e rekrutimit në përputhje të plotë me Udhëzimin Administrativ për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të zv. Drejtorit të Institucionit Edukativo Arsimor dhe Aftësues duke theksuar se njoftimi është bërë në mënyrë të rregullt, bazuar në nenin 8, pika 2.7.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe Zv. Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, ku shprehimisht thuhet se *“informimi i kandidatëve bëhet përmes faqes zyrtare të institucionit që ka përgjegjësi t’i informoj kandidatët dhe me postë elektronike, apo me mesazh ose telefon, për kandidatët që kanë shënuar kontaktet e tyre.* Tutje ka theksuar se pala paditëse ka lëshuar afatet ligjore për kontestin gjyqësor sepse nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatë e deri te njoftimi, kanë kaluar tre muaj.

Gjendja faktike e vërtetuar:

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova: Njoftimi i datës 23.06.2023 për mbajtjen e intervistës; Kërkesa drejtuar MASHT-it, e datës 24.07.2023; Opinioni ligjor i MASHT-it, i datës 04.08.2023; Njoftimi me nr 61-207, të datës 16.03.2023 (e konkursit të parë për mbajtjen e intervistave ky njoftim vërteton se paditësi është përjashtuar nga intervista); Rishpallja e konkursit, e datës 01.06.2023; Plani mësimor për profilin mësimdhënës, niveli 1 dhe 2, që paditësi bën pjesë në rubrikën “B” nr. 5 “Njohja e Mallit; Vendimi me lëndën 05 nr

29605/23, i datës së protokollit 27.03.2023 për refuzimin e ankesës; Ankesa ndaj vendimit nr 05/27566, i datës 22.03.2023 të paraqitur nga paditësi; Licenca për mësimdhënës me nr 100020188, e datës 20.05.2014; Lista e pagave me nr EM 00014856, e cila vërteton kompensimin për kualifikim Mr-Dr; Diploma e fakultetit e datës 14.11.2019, me nr. 573; Kontrata e punës 05 nr 121/2014, e datës 13.10.2014; Kontrata e punës me nr 196/19, e datës 06.03.2019 si dhe Shtojca e masterit e lëshuar në emër të paditësit nga Universiteti i Prishtinës.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartëcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç e të gjitha ato së bashku duke mos u lëshuar në provat të cilat janë irelevante për vendosjen në këtë çështje juridiko kontestimore dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase:

Nga Njoftimi i datës 23.06.2023 për mbajtjen e intervistës, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura ka publikuar njoftim mbi mbajtjen e intervistave për kandidatët të cilët i kanë plotësuar kushtet e konkursit, ashtu që, emri i paditësit nuk ka figuruar në tabelën e shpalljes. Në njoftimin e lartëcekur, kandidatët e pakënaqur të cilët nuk janë përfshirë në listën e ngushtë, janë udhëzuar në të drejtën e ankesës me shkrim në afatin kohor prej 8 (tetë) ditësh nga dita e shpalljes së këtij njoftimi, komisionit të ankesave të DKA-së.

Nga Kërkesa drejtuar MASHT-it, e datës 24.07.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i është drejtuar MASHT-it me kërkesë me të cilën ka kërkuar interpretim ligjor lidhur me çështjen e konkursit për Drejtor Shkolle të Mesme Ekonomike në Gjilan.

Nga Opinioni ligjor i MASHT-it, i datës 04.08.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se e njehta i është drejtuar paditësit me konstatimin se nëse i njëjti do të ndiqte procedurat gjyqësore siç është udhëzuar me vendimin e Komisionit për Ankesa të Komunës së Gjilanit, mundësitë që të anulohet konkursi kanë ekzistuar, por në rastin e paditësit, i njëjti i ka lëshuar afatet ligjore për kontest gjyqësor sepse ka patur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë afat për t'iu drejtuar gjykatës, ndërsa tani kanë kaluar tre muaj.

Nga Kontrata e punës 05 nr 121/2014, e datës 13.10.2014, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi Fadil Latifi ka qenë i punësuar te e paditura në pozitën zv.drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike “Marin Barleti” në Gjilan.

Nga Kontrata e punës me nr 196/19, e datës 06.03.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi F. L. ka qenë i punësuar te e paditura në pozitën e ushtruesit të detyrës i Shkollës së Mesme Ekonomike “M. B.” në Gj..

Baza ligjore:

Gjykata, në këtë çështje kontestimore ka aplikuar dispozitat e Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, gjegjësisht nenit 78, par. 1, në të cilin theksohet se *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo*

organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”, par. 2, ku përcaktohet “Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”, nenin 3 “Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”. Gjithashtu duke u bazuar në nenin 319.1 dhe nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-ës, ku neni 319.1 ka paraparë “secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, kurse neni 322.1 ka paraparë “në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës”, ndërsa neni 322.2 ka paraparë “pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës:

Për gjykatën nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura si zv. drejtor dhe ushtrues detyre i postit të drejtorit në Shkollën e Mesme “Marin Barleti” në Gjilan, fakt ky i cili është provuar nga Kontratat e Punës që paditësi ka lidhur me Shkollën e Mesme “Marin Barleti” në Gjilan. Për gjykatën nuk ishte kontestues as fakti se përmes njoftimit të datës 23.06.2023, e paditura ka ftuar kandidatët e caktuar për intervistë dhe se paditësin e ka përjashtuar nga intervista duke mos dhënë asnjë sqarim se pse paditësi nuk është në listën e personave të thirrur për intervistë. Gjykata e mori si kontestues faktin nëse paditësi ka shterrur ose jo të gjitha mjetet e brendshme juridike para se të paraqes padi në gjykatë dhe gjeti se i njëjti edhe përkundër faktit se është informuar përmes njoftimit të datës 23.06.2023, si dhe përkundër faktit se është udhëzuar në të drejtën në ankesë në afatin kohor brenda 8 (tetë) ditësh, i njëjti nuk ka paraqitur ankesë brenda afatit ligjor, por pas kalimit të afatit kohor prej 3 (tre) muajsh, ka dorëzuar padi në gjykatë për anulimin e njoftimit të lartëcekur, për çka gjykata në mungesë të shterrjes së mjeteve të brendshme juridike, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke u mbështetur edhe në par. 2, të nenit 78 të Ligjit të Punës, ku përcaktohet “Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”, nenin 3 “Vendimi nga paragrafi 2. i këtij neni, i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej tetë (8) ditësh”.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimin e palës paditëse për dëmshpërblimin e dëmit si pasojë e shqetësimit emocional, në shumën prej 6,000.00 euro, si pasojë e njoftimit të datës 23.06.2023, dhe nje pretendim të tillë e gjeti si të pabazuar sepse paditësi me asnjë provë të vetme materiale kësaj gjykate nuk i ka argumentuar faktin se i njëjti ka përjetuar shqetësim të madh emocional nga njoftimi i lartëcekur dhe në mungesë të ndonjë prove relevante, e duke u bazuar edhe në nenin 319.1 dhe nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-së, ku neni 319.1 ka paraparë “secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”, kurse neni 322.1 ka paraparë “në qoftëse gjykata në bazë të provave të marrura (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke aplikuar rregullat mbi barrën e provës”, ndërsa neni 322.2 ka paraparë “pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është

qenësor për krijimin ose realizimin e saj po qe se ligji nuk parasheh diç tjetër”, gjykata refuzoi kërkesëpadinë e paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe 450, e lidhur me nenin 463 të LPK-së.

Nga të lartëcekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 par. 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
C.nr.1470/2023, më datën 26.03.2024

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

UDHËZIMI MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj gjykate.